



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrat

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zgjerimi i veprimtarisë së shkollës profesionale

**NUMËR:6/2007**

**DATË: 2.04.2007**

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr.21/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 7.3 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

### Neni 1

#### Qëllimi

Me këtë UA përcaktohen kushtet, mënyra e organizimit dhe zgjerimit të punës prodhuese dhe shërbyese në shkollat profesionale si dhe rregullat e grumbullimit dhe shfrytëzimit të të hyrave vetanake.

### Neni 2

#### Veprimtaria prodhuese dhe shërbyese

1. Shkollat mund ta zgjerojnë veprimtarinë prodhuese dhe shërbyese në harmoni me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Zgjerimi i veprimtarisë prodhuese dhe shërbyese të shkollës, është në funksion të përparimit dhe zhvillimit të mësimin praktik dhe kompetencave profesionale të nxënësve për aftësimin e tyre në punë.

3. Shkolla zgjeron veprimtarinë prodhuese dhe shërbyese vetëm në kuadër të veprimtarisë të cilën e ka të licencuar me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tutje MASHT).

4. Për realizim të suksesshëm të pikës 2.2 të këtij neni, shkolla bashkëpunon me institucione dhe organizata tjera.

### **Neni 3**

#### **Mjetet vetanake të shkollës**

Burimet, mënyra e grumbullimit, menaxhimit, realizimit, mirëmbajtjes së dokumentacionit financiar, inspektimit dhe auditimit të mjeteve vetanake të shkollës bëhen sipas UA 71/2004, si dhe akteve tjera nënligjore.

### **Neni 4**

#### **Angazhimi i personelit mësimor dhe i ekspertëve**

1. Personeli i shkollës me orar të plotë të punës, mund të angazhohet në punë shtesë prodhuese-shërbyese deri në 50% (gjysmën) e orarit të punës.

2. Sipas nevojës, shkolla mund të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm me kontratë, nëse ka nevojë për profile profesionale në mënyrë që puna prodhuese apo shërbyese të jetë kualitative.

### **Neni 5**

#### **Marrja e të drejtës për organizimin e punës prodhuese dhe shërbyese**

MASHT-i i kufizon shkollës profesionale të drejtën për organizimin e punës prodhuese dhe shërbyese nëse:

1. nuk vepron në harmoni me dispozitat e këtij UA dhe dispozitat tjera që kanë të bëjnë me këtë veprimtari;
2. nuk vepron sipas dispozitave të rregullores së shkollës profesionale me të cilat rregullohet kjo veprimtari;
3. i thyen rregullat sipas nenit 2 të këtij UA;
4. organi kompetent i arsimit konstaton se mjetet vetanake nuk shfrytëzohen drejt;
5. nuk ka evidencë të punës dhe dokumentacion financiar;
6. nuk merren masa të nevojshme higjieno-sanitare për mbrojtjen e shëndetit të nxënësve;
7. shkelen të drejtat e nxënësve ose të personelit profesional, dhe
8. në raste të tjera të parapara me dispozita ligjore.

## **Neni 6**

### **Rregulloret**

1. Shkolla harton rregulloren për llojin e prodhimitarisë ose shërbimit dhe aneksin i cili përmban çmimin e çdo shërbimi ose prodhimi.
2. Rregullorja duhet të jetë e pranuar nga MASHT

## **Neni 7**

### **Shfrytëzimi i mjeteve plotësuese**

Shkolla mund t'i shfrytëzojë mjetet financiare për qëllime si:

1. për mirëmbajtjen e mjeteve, pajimeve dhe objektit;
2. për furnizimin me vegla, pajisje dhe literaturë profesionale;
3. për zhvillimin e planeve dhe të programeve;
4. për arsimimin dhe aftësimin e arsimtarëve dhe të bashkëpunëtorëve për lëndët profesionale;
5. për angazhimin e ekspertëve të profesioneve të ndryshme me qëllim përparimi të mësimin profesional ose praktik (seminare të shkurtra ose trajnime profesionale);
6. për vizita dhe ekskursione profesionale, të parapara me planprogramin mësimor dhe planin vjetor të punës;
7. për organizimin e garave vendore dhe ndërkombëtare të shkollave profesionale;
8. për shpërblime të nxënësve;
9. për projekte të cilat ndikojnë në përparimin e punës arsimore-profesionale të pranuar nga MASHT;
10. për shpenzimet e pjesëmarrjes së nxënësve në gara vendore dhe ndërkombëtare.

## **Neni 8**

### **Zbatimi**

1. Ky Udhëzim administrativ mund të zbatohet edhe në shkollat të cilat organizojnë arsim dhe aftësim për të rritur.
2. Mbikëqyrjen për zbatimin e këtij UA e bën MASHT.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Ky UA hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga ministri

---

**Agim Veliu, ministër**